

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR - MARS 2025

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	06.01.2025	Kerkese per material arkivor per objektin "BANESA CABEJ/BABAMETO", Monument Kulture Kategoria e Pare, Gjirokaster.	08.01.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 08.01.2025, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link kopje digjitale të dokumentacionit arkivor që disponojmë në Arkivin Teknik për objektin "Babameto/Cabej", Gjirokaster: https://www.transferxl.com/download/08vd4Mtckq6GLv	E plotë	Jo
2	06.01.2025	Kerkese per material arkivor per objektin "Muzeu Kombetar i Fotografise "Marubi", Shkoder	14.01.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", neni 61 "Dokumentet që administrohen në institucionet arkivore shtetërore, jepen për shfrytëzim pasi kanë kaluar 25 vjet nga data e krijimit" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", ju bejme me dije si me poshte: Në Arkivin Teknik të IKTK-së disponojmë dosje teknike për objektet brenda Qendrës Historike Shkodër, ku pjese përbërëse e dosjes eshte edhe objekti i godinës se fototekës "Marubi". Për këtë objekt nuk disponojme rilevime apo foto te vjetra, por vetem një projekt si me poshte vijon: "Restaurimi dhe muzealizimi i godinës se Fototekës "Marubi", Shkodër, viti 2014, hartuar nga "Atelier4". Per sa më sipër, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje digjitale të projektit. Gjithashtu, mbështetur në Ligjin nr 35/ 2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to", duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor. https://www.transferxl.com/it/download/08jMvNT4Q62y64		

3	07.01.2025	Sa projekte zhvillimore ka ndërmarrë Ministria e Kulturës në kuadër të programt “100 fshatrat”? Sa është vlera e investimit? Ju lutem na vini në dispozicion listën e projekteve që ka përfutuar secili prej këtyre fshatrave dhe llojin e ndërhyrjes së përfutuar... - A ka ndërhyrë me projekte konkrete ky institucion në fshatrat: Shëngjergj, Fishtë, Kukël, Shetaj, Karpen, Nivicë, Kucc, Guri i Bardhë? Nëse po, ju lutem na vini në dispozicion, cilat janë projektet konkrete, fondi i investuar dhe kompania fituese.. - A keni ndërtuar një mekanizëm kontrolli se si kanë ndikuar këto investime në rigjallërimin e këtyre 100 fshatrave?	14.01.2022	Ne vijim te kërkeses per informacion nga Top Chanel, gjëni bashkelidhur pergjigjen sipas fushes se kompetences se IKTk. Sa projekte zhvillimore ka ndërmarrë Ministria e Kulturës në kuadër të programt “100 fshatrat”? Sa është vlera e investimit? Ju lutem na vini në dispozicion listën e projekteve që ka përfutuar secili prej këtyre fshatrave dhe llojin e ndërhyrjes së përfutuar... <i>Lidhur me kërkesën për projekte zhvillimore të ndërmarrë apo vlera investimi, IKTk ka kontrolluar nga lista totale e projekteve të detajuara sipas 100 fshatrave me vendimet e projekteve të miratuara në KKTKM dhe disponon të dhëna për 1 pjesë të projekteve ku ka pasur objekte pasuri kulturore ose kane qene objekt shqyrtimi ne KKTKM, që mund te kenë qenë pjesë e listës fillestare së 100 fshatrave, të hartuara nga subjekte (private, publike) dhe të cilat janë aplikuar nga palët e interesuara në sistemin online e-lejet dhe janë shqyrtuar e miratuar (në KKTKM).</i> <i>Bashkelidhur lista ku jane evidentuar projektet e cituara.</i> A ka ndërhyrë me projekte konkrete ky institucion në fshatrat: Shëngjergj, Fishtë, Kukël, Shetaj, Karpen, Nivicë, Kucc, Guri i Bardhë? Nëse po, ju lutem na vini në dispozicion, cilat janë projektet konkrete, fondi i investuar dhe kompania fituese. <i>Projekti i restaurimit të banesës së At Gjergj Fishtës dhe Itinerari Fishtian (Fishtë)</i> A keni ndërtuar një mekanizëm kontrolli se si kanë ndikuar këto investime në rigjallërimin e këtyre 100 fshatrave? <i>IKTK nuk disponon informacion.</i> <i>Shenim: Databaza bashkelidhur me listen e detajuar te projekteve pjese e 100 fshatrave eshte databaze e percjelle nga Ministria e Kultures ne vitin 2022 prane IKTk. Per qellim thjeshtimi te kontrollit, IKTk ka verifikuar sipas projekteve pjese te kesaj liste.</i>	E plotë	Jo
---	------------	--	------------	---	---------	----

4	06.01.2025	Kërkesë pwr informacion ne lidhje me objektin/projektin "Restaurimi dhe muzealizimi i godinës se Fototekës "Marubi", Shkodër		Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, neni 61 “Dokumentet që administrohen në institucionet arkivore shtetërore, jepen për shfrytëzim pasi kanë kaluar 25 vjet nga data e krijimit” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju bejme me dije si me poshte: Në Arkivin Teknik të IKTK-së disponojmë dosje teknike për objektet brenda Qendrës Historike Shkodër, ku pjese përbërëse e dosjes eshte edhe objekti i godinës se fototekës "Marubi". Për këtë objekt nuk disponojme rlevime apo foto te vjetra, por vetem një projekt si me poshte vijon: "Restaurimi dhe muzealizimi i godinës se Fototekës "Marubi", Shkodër, viti 2014, hartuar nga "Atelier4". Per sa më sipër, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje digjitale të projektit. Gjithashtu, mbështetur në Ligjin nr 35/ 2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor. https://www.transferxl.com/it/download/08jMvNT4Q62y64	E plotë	Jo
5	06.01.2025	Kwrkesw pwr informacion nw lidhje me aplikimin per Licencen ne veprimtari nderhyrese ne pasurite kulturore materiale.	10.01.2025	Keshilli Kombetar i Trashegimise Kulturore Materiale ne mbledhjen e dates 10.01.2025, vendosi miratimin e kerkeses se shoqerise Vibtis për pajisje me licencë në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore me drejtues Teknik znj. Denisa Shehu në kategorinë (A): për nënkategoritë Z/A/1, Z/A/2, Z/A/3; Z/A/4; Z/A/5; Z/A/6; Z/A/7. Sekretaria Teknike vijon me zbardhjen e Vendimmarrjes se KKTKM ne perputhje me percaktimet e Nenit 6, pika 5 te Urdherit Nr. 223, datë 3.7.2020 "Për Miratimin e rregullores “Për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj”. Ju do te njoftoheni me Vendimin e zbardhur nepermjet sistemit e-albania ne vijim te aplikimit tuaj me Nr. Gjurmimi IKTK-2024-2605047-VY.	E plotë	Jo

				Per sa i takon pajisjes me kartonin e licences , do te ndiqet procedura e percaktuar ne VKM Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, i ndryshuar, kreu IV, germa B) pika 5 e cila citon se: <i>pika 5. Sekretaria Teknike bën shpërndarjen e licencave të interesuarve jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e urdhrit të ministrit, nëpërmjet shërbimit postar ose licencat tërhiqen nga vetë personi i licencuar apo nga persona të autorizuar me akt noterial për të kryer një veprim të tillë apo personat e autorizuar nga personi juridik. Kopja e autorizimit depozitohet në dosjen që arkivohet.</i>		
6	10.01.2025	Kerkese per pajisje me dokumentacion arkivor/dosje teknike per objektin "Godina e Teatrit te Kukullave" apo (Godina e Ish Parlamentit te pare Shqiptar), Tirane.	13.01.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së datë 10.01.2025, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, neni 61 “Dokumentet që administrohen në institucionet arkivore shtetërore, jepen për shfrytëzim pasi kanë kaluar 25 vjet nga data e krijimit” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju bejme me dije si me poshte: Ne Arkivin Teknik te IKTK-se disponojme dosje teknike per objektin "Godina e Teatrit te Kukullave" apo (Godina e Ish Parlamentit te pare Shqiptar), Tirane. Dosja permban rlevime te objektit si dhe projekte te nderhyrjeve restauruese nder vite te godines. Per sa me siper, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje digjitale të dokumentacionit te plote arkivor qe disponojme per këtë objekt. Gjithashtu, mbështetur në Ligjin nr 35/ 2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor. https://www.transferxl.com/download/00v8zBJHKLwwrV	E plotë	Jo
7	16.01.2025	A është prodhuar kartoni i Licencës për veprimtari arkeologjike A1 me nr. vendim 387, datë 27.09.2024 ?	17.01.2025	Ne vijim te kerkeses tuaj date 16.01.2025 mbi pajisjen me kartonit te licences, Ju bejme me dije se: Ju do te njoftoheni nga Sekretaria Teknike per terheqjen e kartonit te licences. Lutemi te siguroheni qe keni dorezuar	E plotë	Jo

				ne Sekretarine Teknike 2 (dy) fotografi me përmasa 3x4 cm , sipas percaktimeve te VKM Nr. 793, datë 7.10.2020 Kreu III, Neni 7, germa dh) dhe Kreu VI, Neni 12, Pika 4, germa a).		
8	17.01.2025	Kërkesë pwr vënienn në dispozicion te planimetrisë të katit përdhe te projektit kur eshte ndertuar vila nr.28 ne rrugen “Papa Gjon Pali II” ne kryqezim me rrugen “ Jul Variboba”.	21.01.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “<i>Për Arkivat</i>” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, Ju informojme se: Ne Arkivin Teknik të IKTK-se nuk disponojmë dokumentacion arkivor per vilën nr.28 ne rrugën “Papa Gjon Pali II” në qytetin e Tiranës. Ju informojmë se në ndihmë të studimit tuaj mund t’ju vij botimi i mëposhtëm: Vera Bushati “<i>Vilat e Tiranës</i>”, shtëpia botuese “Universiteti Polis”, viti 2012.	E plotë	Jo
9	19.01.2025	Ankese: tejkallim te punimeve ne zonen arkeologjike, Bashkia Lezhe	06.02.2025	Lidhur me kërkesën Tuaj, përcjellë nëpërmjet adresës zyrtare të IKTK-së, për inspektim dhe vleresim në Parkun Arkeologjik të Lezhës, në lidhje me punimet e realizuara nga Z..., brenda zonës arkeologjike “A”, Ju bëjmë me dije se: Në vijim të trajtimit të kërkesës Suaj, Drejtoria Ranjonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër (DRTK), në cilësinë e institucionit përgjegjës që administron territorin, bazuar në ligjin Nr. 27/2018 “<i>Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë</i>”, në datën 30.01.2025, ka realizuar inspektim në terren. Pas inspektimit në terren nga specialistët e DRTK Shkodër, në Relacionin e Inspektimit përcjellë pranë postës elektronike zyrtare të IKTK-së, në datën 30.01.2025, rezulton se: - Në terren nuk po kryheshin punime në sipërfaqe, ndërtime të reja, punime gërmimi dherash apo cënim i pasurive arkeologjike në zonë arkeologjike “A”. - Gjithashtu, DRTK Shkoder ka inspektuar objektin në fjalë më 18.03.2021, në përgjigje të kërkesës për legalizim si objekt shtesë kati. Nga ky inspektim është evidentuar e njëjtja situatë në territor, pa	E plotë	Jo

				punime në proces, apo ndërhyrje që kishin cënuar arkeologjinë e zonës. Ankesa Juaj, i referohet ndërhyrjeve të kryera nga Z. në periudhën 15-30 Janar 2021, punime të cilat referoni se kanë tejkaluar lejen e ndërtimit, miratuar me shkresën Nr. 22044/1 Prot. datë, 18.12.2020 e Bashkisë Lezhë, duke rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Sa më sipër, ndodhur në situatën aktuale, IKTK dhe DRTK Shkodër ju bejne me dije se territori në fjalë, është kthyer në gjëndjen e tij të mëparshme. Bashkëlidhur gjeni fotot nga inspektimi në terren i situatës nga specialistët e DRTK Shkodër.		
10	15.01.2025	Kërkesë për saktwsimin e Vendimit Nr. 11 date 10.01.2025 te Kwshillit Kombetar tëTrashëgimisë Kulturore	27.01.2025	Ne vijim te kerkeses tuaj me email date 15.01.2025, me te cilen kerkoni nje saktessim ne emertimin e projektit konform Raportit te Vezhgimit Arkeologjik, te miratuar me Vendimit Nr. 11 date 10.1.2025 te KKTKM, sqarojme se: Ne aplikimin me nr. AN061220240006, me aplikues ABKONS dhe zhvillues subjekti SPV Blue 2, Raporti i Vezhgimit arkeologjik i ngarkuar ka titull "<i>Linja e Transmetimit 220 kV N.S BLUE2 – N.S HOXHARE</i>", <i>BASHKIA FIER</i>" si dhe eshte sigluar nga subjekti i licencuar ne arkeologji z. Skender Mucaj ne date 06.12.2024. Pas shqyrtimit ne Keshillet perkatese, emertimi ne piken 1 te vendimit eshte bazuar ne kete material te ngarkuar ne sistem. Ndersa Raporti i Vezhgimit arkeologjik i derguar nga ana juaj me e-mail ne dt. 15 janar ka tjeter date siglimi nga subjekti i licencuar z. Mucaj (date 27.12.2024). Pra materiali i sakte me emrin qe ju kerkoni nuk na eshte vendosur ne dispozicion ne kohe ne aplikimin tuaj ne sistem. Ndodhur ne keto kushte, pasi u njohem me kerkesen tuaj, si dhe duke vleresuar faktin se projekti ne vetvete nuk ka ndryshim te gjurmes apo siperfaqes, Sekretaria Teknike ka marre ne shqyrtim kerkesen dhe po ndjek te gjitha hapat per korrigjimin e emrit te projektit ne Vendimin KKTKM nr. 11 date 10.01.2025, sipas materialit te derguar ne email: <i>"Linja e Transmetimit 220 kV Nenstacioni Blue 2 - Nenstacioni Hoxhare" dhe "Nenstacioni 220/35 kV Blue 2" Bashkia Fier.</i>	E plotë	Jo

				Ju do te njoftoheni serish me e-mail si dhe ne rruge shkresore pas korrigjimit te vendimit.		
11		Sqarim mbi mwnyrwn e aplikimit per te shtyre afatin e licences	29.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj, datë 29.01.2025, dërguar me email në adresën zyrtare pranë IKTK-së në lidhje me aplikimin për shtyrje afati në Licencë për Veprimtari ndërhyrese në Pasuri Kulturore Materiale, ju bëjmë me dije se: Bazuar në VKM Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë Kulturore Materiale”, i ndryshuar, personi fizik/juridik duhet të plotësojë kriteret e posaçme për licencim sipas Kreut II / C dhe kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet përkatëse për pajisjen me licencë sipas Kreut III Ç, pika 3. Për shqyrtimin e kërkesës pranë IKTK-së është i nevojshëm aplikimi nëpërmjet portalit qeveritar www.e-albania.al, në kategorinë “Licencë për veprimtari ndërhyrese në pasuri kulturore materiale”, sipas linkut: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14379 Për sa më sipër, në rastet kur nga ana juaj konstatohen problematika gjatë fazës së aplikimit, duhet të kontaktoni në helpdesk@e-albania.al.	E plotë	Jo
12	26.02.2025	Kërkesë për informacion: Projektet ku ka qene bashkautor Z...	21.03.2025	Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore dhe Drejtoria Rajonale e Trashegimise Kulturore Korçë pasi verifikoi projektet e realizuara ndër vite rezulton se projektet në të cilat ka punuar Z..... janë si më poshtë : 1.Projekti i restaurimit të kishës së “Shën Athanasit”, Polenë, Korçë 2019- nuk disponojme projektin; 2.Projekti i restaurimit të kishes “Burimi Jetedhenes”, Korce 2018 - nuk disponojme projektin; 3.Projekti i restaurimit të kishës së “Profetit Ilia”, Voskopojë, Korçë 2017 - eshte b/autor projekti ; 4.Projekti i restaurimit të kishës së “Ristozit”, Mborje, Korçë 2017 - nuk eshte b/autor projekti;	E plotë	Jo

				5.Projekti i restaurimit të kishës së “Shën Joan Pagëzorit”, Boboshticë, Korçë 2016 - është b/autor projekti; 6.Projekti i restaurimit të Manastirit të “Shën Pjetrit”, Vithkuq, Korçë 2016 - është b/autor projekti; 7.Projekti i restaurimit të qimitirit të “Shën Kozmait”, Vithkuq, Korçë 2016 - nuk është b/autor projekti; 8.Projekti i restaurimit të kishës së “Shën Nikollës”, Voskopojë, Korçë 2016 - nuk është b/autor projekti; 9.Projekti i restaurimit të kishës “Fjetja e Hyjlindëses”, Voskopojë, Korçë 2016 - është b/autor projekti viti 2015; 10.Projekti i restaurimit të kishës së “Kryeëngjëjve Mikael dhe Rafael”, Voskopojë, Korçë 2016 - nuk e disponojme projektin e vitit 2016; 11. Banesë në Bulevard Republika, rikonstruksion dhe shtesë, z. Spiro Kapurani 2010 - është b/autor projekti; 12. Banesë në Bulevard Republika, rikonstruksion dhe shtesë, z. Nikolla Riza - është b/autor projekti. 13. Banesë në Bulevard Republika, rikonstruksion dhe shtesë, z. Spiro Kapurani 2010 14. Banesë në Bulevard Republika, rikonstruksion dhe shtesë, z. Nikolla Riza		
13	04.03.2025	Kërkesë për materiale arkivore per banesen me kod arkivi teknik G 113, në lagjen Goricë, Berat.	06.03.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “<i>Për Arkivat</i>” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, Ju bejme me dije se: Ne Arkivin Teknik te IKTK-se disponojme dosje teknike per objektin pasuri kulturore "Banesa e Xhovani Kajana" ne lagjen "Gorice", Berat, me kod G 113 me dokumentacionin arkivor si me poshte vijon: • Rilevime te objektit dhe nderhyrje restauruese te vitev '80-te shek XX; • Foto historike. Per sa me siper, ju dergojme bashkelidhur ne link kopje digjitale te dokumentacionit te plote arkivor ne ndihme te punes suaj. Mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "<i>Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to</i>", duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur te perdoren dokumentat arkivor.	E plotë	Jo

14	06.03.2025	Kërkesë për të mundësuar restaurimin e shtëpisë, objekt monument kulture	25.05.2025	Pas verifikimeve të kryera në IKTK, rezultoi se kërkesa e _____, është shqyrtuar edhe me parë nga institucioni i jone, kur në datë 24.10.2024 _____ i është drejtuar nepermjet postës elektronike MEKI-t dhe kjo e fundit e ka përcjellë për trajtim në IKTK në datë 25.10.2024. Banesa e Z.Xhambazi rezultoi të jetë pjesë e Qendres Historike të qytetit të Pogradecit të shpallur me Vendim Nr.554, datë 18.06.2015 "<i>Per shpalljen e Qendres Historike te qytetit te Pogradecit dhe miratimin e rregullores per administrimin e saj</i>". Në lidhje me Qendren Historike është hartuar dhe miratuar me Vendim Nr. 598, datë 08.10.2021 të KKTKM-se projekti "<i>RESTAURIMI DHE RIKUALIFIKIMI URBAN I QENDRES HISTORIKE DHE ZONES SE MBROJTUR TE QYTETIT TE POGRADECIT</i>", me aplikues SPHERA shpk., Rest. Genc Samimi dhe zhvillues Bashkia Pogradec. Në këtë projekt banesa në fjalë është e identifikuar me kod B.PG.36, për të cilën në fletët grafike pasqyrohet vetëm gjendja ekzistuese me soletë betoni, pa parashikuar ndërhyrje në të. Sa me sipër duke qenë se mbarevajtja e këtij projekti po ndiqet nga Bashkia Pogradec, IKTK nuk disponon informacion shtesë mbi rastin në fjalë.	E plotë	Jo
15	17.03.2025	Kërkesë për informacion, rreth Shtëpisë së Libohovitëve, e ndodhur brenda Kalasë së Tiranës.	19.03.2025	Në vijim të kërkesës Suaj, përcjellë në emalin zyrtar të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, ju bejme me dije si më poshtë: Ju mund të paraqiteni pranë arkivit teknik të IKTK-se çdo ditë të javës nga dita e hënë - enjte ora 08:00-16:30 dhe ditën e premte ora 08:00-14:00, me qëllim hulumtimin e materialeve arkivore, që disponojmë lidhur me objektin e temës suaj të diplomës.	E plotë	Jo
16	26.03.2025	Kërkesë për informacion lidhur me objektet arkeologjike dhe kulturore	26.03.2025	Referuar kërkesës suaj, shumë voluminoze, e cila ka një paqartësi në lidhje me tipologjinë e dokumentit që ju nevojitet, lutemi të aksesoni Arkivin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore nga <i>e hënë-e enjte ora 08:00-16:30, dhe ditën e premte ora 08:00-14:00.</i>	E plotë	Jo